



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Date/Datum

281/20

12.06.20

PRISHTINË - PRISTINA

**PSH .nr. 281/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas nenit 23 të Rregullores së Punës së OSHP-së përkitazi me ankesën e parashtruar nga operatori ekonomik: “Arfa Group” sh.p.k., “Euroasphalt” sh.p.k-Deçan, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Junik, më datën: 11.06.2020, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. HEDHET SI E PA LEJUAR**, ankesa e operatorit ekonomik: “ARFA GROUP” Sh.P.K. & “EUROASPHALT” Sh.P.K. - Deçan lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, me numër të prok: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Junik.

**II.** Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që i njëjti operator ekonomik është konsideruar si palë pa interes juridik material konform nenit 4. 26 e LPP-së, andaj të njëjtit operator ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës.

**III. Obligohet**, OE ankues që konform nenit 31 pika 4 te Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A R S Y E T I M**

Operatori ekonomik ankues “Arfa Group” sh.p.k., “Euroasphalt” sh.p.k-Deçan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.05.2020 me nr.281/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të

prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Junik, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 4, 6, 7, 59, 108/A dhe nenin 111 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:22.05.2020 ka konstatuar se:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Arfa Group” sh.p.k., “Euroasphalt” sh.p.k-Deçan, Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në ankesën e tij jep argumentet e tij se i njëjti padrejtësisht është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit dhe njëherit pretendimin e tij e bazon edhe në një interpretim të KRPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet e OE ankues nuk kanë të bëjnë me kërkesa të dosjes së tenderit dhe se për këtë çështje ka vendosur paneli shqyrtues. Prandaj e konsideroj si çështje të gjykuar nga ana e PSH-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të refuzohen si të pabazuara, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 22.05.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “Arfa Group” sh.p.k., “Euroasphalt” sh.p.k-Deçan, me datë: 26.05.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.06.2020, pa praninë e palëve konfirmon nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.



**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të eksperteve shqyrtues/technik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me ankesën e OE ankues “ARFA GROUP” Sh.P.K. & “EUROASPHALT” Sh.P.K. – Deçan, Paneli Shqyrtues sqaron se vendimin PSH. nr. 831/19 të datës 17.12.2019, OE “Arfa” është konstatuar se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-se të vendosura në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit që do të thotë se ky OE është i pa përgjegjshëm. Për më tepër është kualifikuar si palë pa interes juridik material në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 4.1.26 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, vendimin e mëhershëm të Panelit Shqyrtues PSH. nr. 831/19 të datës 17.12.2019, si dhe mendimin e ekspertit të dhënë në raport sa i përket ankesës së OE ankues, vlerëson se të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues janë shqyrtuar në vendimin e lartcekur, andaj duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar, dhe pretendimet ankimore janë vlerësuar si të pabazuara sipas këtij vendimi, paneli shqyrtues vlerëson se OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 dhe 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK- Komuna Junik
- 1x1 OE “Arfa Group” sh.p.k., “Euroasphalt” sh.p.k-Deçan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.